



Informata *për prindërit*

për vlerësimin në shkollat fillore dhe
për kalimin në shkollën sekondare I.

Versioni i përpunuar gusht 2008



Të dashur prindër

Si vlerësohen në të vërtetë nxënësit në shkollat tona? Kush e bënë këtë vlerësim dhe pse bëhet kjo? Çfarë nënkupton njeriu me një vendim për karrierë? Çfarë vendoset aty dhe kush vendosë? Si funksionon në fund mënyra e kalimit nga shkolla fillore në shkollën sekondare I, çfarë është një protokoll kalues, pse mbahet një bisedë kaluese dhe kush sjell vendimin për kalim?

Shkurt: Çfarë duhet të dini për karrierën shkollore të fëmijës tuaj?

Kjo shkresë informative që keni përpara ju jep përgjigje në këto pyetje. Kjo iu drejtohet ju si prindër, respektivisht si edukatorë ligjorë të nxënësve të shkollës fillore të Bernës. Në qoftë se keni nevojë për informata të tjera, ju lutemi të paraqiteni tek mësimmshënësi i fëmijës tuaj ose tek drejtorja e shkollës.

Drejtorja për Edukim

Qëllimet e mësimit

Qëllimet e mësimit formojnë parakushtin për secilin mësım kuptimplotë. Në planprogramin mësımor të Bernës udhëzimet e përcaktuara janë në formë të qëllimeve të përafërta. Formulimi i këtyre qëllimeve të përafërta në qëllimet e të mësuarit për grupet konkrete të nxënësve, periudha kohore dhe unifikimi i mësimit është punë e mësım-dhënësve. Ata konstatojnë në mënyrë të paanshme dhe specifike se cilat përgjegjësi duhet t'i mësojnë nxënësit për t'ia arritur qëllimeve përkatëse të mësimit.

Për verifikimin (rishqyrtimin), se a kanë arritur nxënësit qëllimet e mësimit, ekzistojnë forma të ndryshme vlerësimi (shih kapitullin vijues). Këto vlerësime krijojnë bazën për vendimin e karrierës shkollore. Vendimi i parë i rëndësishëm i karrierës bëhet në fund të vitit të 6-të shkollor, nëse ka të bëjë me kalimin respektivisht me shkallëzimin e nxënësve realë apo sekondarë.



Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i përgjegjësisë ndaj lëndëve dhe sjelljeve të nxënësve nga ana e mësimeve, i takon përditshmërisë shkollë. Ai qëndron në shërbim të nxitjes personale dhe të zhvillimit të të arriturave shkollë dhe duhet të përjetohet si ndihmë personale e të mësuarit.

Vlerësimet nga ana e nxënësve duhet të nxitin, të jenë të orientuara me qëllim mësimit, të kapshme, kjo do të thotë kritikë vetanake dhe të orientuara për të ardhmen si dhe transparente.

- **Nxitja:** vlerësimet nxisin mësimit dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve.

- **Orientimi i qëllimit të mësimit:** vlerësimet shërbejnë që gjërat e mësuarat t'i krahasojnë me kërkesat e paraqitura.

- **Kritika vetanake:** vlerësimet u mundësojnë fëmijëve dhe të rinjve që të vlerësojnë veten.

- **Orientimi drejt së ardhmes:** vlerësimet bartin bazat vendimtare për shkollim të mëtutjeshëm të fëmijëve dhe të rinjve.

- **Transparenca:** vlerësimet informojnë prindërit (edukatorët ligjorë) në mënyrë të diferencuar dhe të kapshme rreth hapave në mësimit dhe zhvillim të vajzës apo djalit tuaj.

Format e vlerësimit të nxënësve

- **Vrojtimi dhe vlerësimi i shoqëruar.** Nxënësit do të vrojtohen dhe testohen rregullisht nga mësimeve. Përvojat dhe rezultatet duhet të kontribuojnë që pas shumë e shumë pyetjeve të kenë mundësi të përgjigjen: si zhvillohet gjendja e diturisë lidhur me qëllimet e mësimit? Si zhvillohet sjellja në shkollë, cilat karakteristika, cilat shkathtësi dhe dobësi shquhen tek nxënësit? Rezultatet e këtyre provave dhe vrojtimit iu shërbejnë mësimeve që këtu të marrin masat përkatëse ndihmëse dhe gjatë bisedës të japin vërejtje (sugjerime) dhe njoftime konkrete.

- **Vetëvlerësimi.** Me vetëvlerësimin nxënësit vlerësojnë përgjegjësinë personale ndaj lëndëve si dhe sjelljen në shoqëri, mësimit dhe punë lidhur me qëllimet e përcaktuara të mësimit. Vetëvlerësimet nxisin dhe forcojnë aftësitë vetëvlerësuese. Ato mund të realizohen në mënyra të ndryshme: si bisedë në grupe apo vetëm për vetëm; si shikim në tremujorin prapa, gjysmëvjetor apo vjetor; si vërejtje për planin javor, punë në projekt apo në punishte. Vetëvlerësimet pasojnë pas një bilanci të mësimeve, por mbahen të pakta një herë në vit. Ata në bisedë me nxënësit do të vlerësojnë në mënyrë të orientuar kërkesat.



• **Biseda me prindërit.** Bisedat me prindërit janë një element kryesor për krijimin e besimit dhe të bashkëpunimit në mes të shkollës dhe shtëpisë dhe mbahen së paku një herë në vit. Ato nxisin kontaktet ndërmjet prindërve dhe mësimit dhe të shërbejnë shkëmbimit të informatave për vajzën gjegjësisht djalin dhe për informacionin lidhur me sjelljen e tij gjegjësisht të saj në shoqëri në kuadër të shkollës. Ato mundësojnë krahasimin në mes të vetëvlerësimit me vlerësimin e huaj përmes mësimit dhe vlerësimin nga këndvështrimi i prindërve. Ato lehtësojnë përpunimin e situatave problematike apo konflikteve duke biseduar drejtpërdrejt për zgjidhjen e tyre. Ato janë vende për diskutim të vlerësimeve të suksesit, të nxitjes dhe qëllimeve të orientuara të mësimit dhe të vendimit për karrierë si dhe për vlerësim të sjelljes në shoqëri.

Në shkallën primare vlerësimi zhvillohet në fund të gjysmëvjetorit të parë në formë bisede me prindërit. Biseda me prindërit në klasën e 6-të është në të njëjtën kohë bisedë për mënyrën kaluese (faqe 8). Në shkallën sekondare I biseda duhet të zhvillohet atëherë kur pjesëmarrësit e shohin të plotkuptimtë, atëherë kur do të përgatitet vendimi për zgjedhjen e profesionit ose ndjekjes së një shkollimi të mëtutjeshëm.

Shkollat ofrojnë biseda plotësuese me prindërit në rast konfliktesh ose ngjarjesh të jashtëzakonshme. Prindërit kanë të drejtë që me një njoftim me shkrim të tërhiqen nga këto biseda.

• **Raporti i vlerësimit.** Në fund të vitit shkollor të shkallës primare dhe në fund të çdo gjysmëvjetori i shkallës sekondare I, prindërit gjegjësisht edukatorët ligjorë marrin një njoftim në formë të raportit vlerësues. Ky raport në një rën anë përbëhet nga vlerësimi i përgjegjësisë ndaj lëndëve në anën tjetër nga vlerësimi i sjellje ndaj punës dhe mësimit. Ai jep informata se deri ku është arritur qëllimi i mësimit në çdo lëndë. Nga viti i 3-të shkollor përgjegjësia e lëndëve vlerësohet me nota. Vlerësimi bëhet sipas këtij shkallëzimi: Në vitin 1. dhe të 2-të shkollor pason vlerësimi në formë teksti (të shkruar) sipas kriterëve me sa vijon:

shumë mirë	mirë	mjaftueshëm	pamjaftueshëm
------------	------	-------------	---------------


Nga viti i 3-të shkollor pason vlerësimi me nota dhe gjysmënota për çdo lëndë, në kuptim të vlerësimit të përgjithshëm.



Notat kanë këto domethënie:

6	shumë mirë	Janë arritur qëllimet e mësimit
5	mirë	
4	mjaftueshëm	
3	pamjaftueshëm	Nuk janë arritur qëllimet e mësimit
2	dobët	
1	shumë dobët	

Vlerësimet në një vështrim

		Gjysmëvjetori i parë	Gjysmëvjetori i dytë
	Shkalla primare	Viti shkollor 1+2	Biseda me prindër Raporti i vlerësimit (pa nota)
		Viti shkollor 3 - 5	Biseda me prindër Raporti i vlerësimit (me nota)
		Viti shkollor 6	Raporti i kalimit Vendimi për kalim Protokolli i kalimit Biseda e kalimit
Shkalla sekondare I	Viti shkollor 7 - 9	Raporti i vlerësimit (me nota)	Raporti i vlerësimit (me nota) Biseda me prindër (koha sipas zgjedhjes)

Vlerësimi dhe vrojtimi i shoqëruar nga mësuesit dhe vetëvlerësimi nga ana e nxënësve mbahen gjatë gjithë kohës së mësimit. Se kur pasojnë vetëvlerësimet, vendosin mësuesit.

Vendimi i karrierës shkollore

Raportet e vlerësimeve të mësimdhënësve, vetëvlerësimet e nxënësve dhe bisedat me prindërit shërbejnë si bazë për vendimin e karrierës shkollore.

Çfarë është një vendim i karrierës shkollore?

Vendimi i karrierës shkollore pason në bazë të një vlerësimi të përbashkët të pyetjes se cila rrugë do të jetë më e mirë për një nxënës të caktuar.

- **Në shkallën primare** vlerësimi përbëhet nga vlerësimi i përgjegjësishë së lëndëve – pra sukseset - në të gjitha lëndët. Vlerësimi i sjelljes ndaj punës dhe mësimi e plotëson vlerësimin e suksesit të nxënësit/es.

- **Në shkallën sekondare I** do të vlerësohen gjithashtu përgjegjësia e lëndëve në të gjitha lëndët obligative. Edhe këtu vjen gjithashtu vlerësimi i sjelljes ndaj punës dhe mësimi.

Sipas rregullit nxënësit kalojnë në vitin shkollor pasues ose në gjysmëvjetorin tjetër të llojit të shkollës së ndjekur gjegjësit të nivelit shkollor. Nga ky parim zbutjet e vendimit të karrierës shkollore janë për shembull puna reduktuese ose zgjeruese e qëllimit të mësimi individual (për fëmijët / të rinjtë me vështirësi në të mësuar respektivisht me aftësi të veçanta) çon në një klasë të veçantë, në përsëritjen e një viti shkollor ose në tejkalimin e një viti shkollor.

Në shkallën sekondare I vlejnjë rregullat e ndërrimit të niveleve në lëndët gjermanisht, frëngjisht dhe matematikë si dhe pranimi në një parapërgatitje për shkollë të mesme, nga kjo vendimi për mësimin gjimnazial në vitin e 9 shkollor si vendim për karrierë shkollore.

Kur vendoset për karrierën shkollore?

Vendimi i karrierës shkollore bihet

- **në shkallën primare**, sipas rregullit në fund të vitit,
- **në shkallën sekondare I** në fund të çdo gjysmëvjetori.

Kush merret me vendimin e karrierës shkollore?

Vendimi për karrierën shkollore bëhet me kërkesë të mbledhjes së mësimdhënësve nga drejtoria e shkollës. Ata njoftojnë prindërit me shkrim. Në çdo vendim jepet orientimi në rrugë të drejtë për ankesë.

Mënyrat e ndryshme të vendimit të karrierës shkollore janë të ndryshme dhe do të kihet kujdes në situata të veçanta. Prindërit do të dëgjohen në çdo rast dhe mendimi i tyre do të jetë brenda vendimit.



Mënyra e kalimit nga shkalla primare në shkallën sekondare I

Shkalla primare dhe shkalla sekondare I

Derisa në të kaluarën kuptimi i “shkollës primare” dhe “shkollës sekondare” nga klasa e 5-të ka shënuar tekste të ndryshme mësimi, - shkohej ose në një shkollë primare ose sekondare, - kuptimet e njëjta sot përdoren në një kuptim të ri:

- **Shkalla primare** përcakton vitet shkollore nga 1 deri në 6. Në shkallën primare të gjithë fëmijët do të mësojnë bashkërisht.

- **Shkalla sekondare I** përcakton vitet shkollore 7 deri në 9 e pavarur nga rruga e ndjekur dhe nivelet ose llojet e shkollave të ndjekura.

Në shkallën sekondare I nxënësit ndjekin ose një klasë reale ose një klasë sekondare ose një klasë në të cilën edhe nxënësit e shkollës primare si dhe të asaj sekondare do të ndjekin mësimet bashkërisht. Çdo komunë vendosë vetë se a do të mësojnë bashkërisht nxënësit e shkollës reale dhe sekondare apo ndaras. Ndonjë qendër e shkollimit të lartë ofron një nivel të shkollimit sekondar special, i cili shërben si parapërgatitje për kalim në shkollën e lartë të mesme. Në shkollat në të cilat nxënësit e shkollës reale dhe sekondare mësojnë bashkë, parimisht është i mundur pas çdo gjysmëvjetori kalimi ose kthimi në real ose sekondar dhe anasjelltas.

Në shkollën sekondare kërkesat janë më të larta se sa në shkollën reale. Prandaj

pranohen nxënësit të cilët i plotësojnë këto kërkesa. Me klasën e 9 në shkollën sekondare fillon për nxënësit mësimi gjimnazial.

Që një nxënës të mbetet në shkollën sekondare, respektivisht reale, pas kalimit në shkallën sekondare I vlejnjë të ashtuquajturat ceremoni të marrjes së dekretit.

Për nxënësit e shkollimit sekondar special, respektivisht të shkollimit sekondar, do të thotë që më së shumti në tri lëndë të obligative të mund të kenë një notë nën 4, pa kusht që të kalojnë në gjysmëvjetorin tjetër. Kjo mund të ndodhë vetëm në njërin prej lëndëve gjermanisht, frëngjisht ose matematikë. Përndryshe pason ndërrimi i përkohshëm i gjysmëvjetorit. Nëse nuk përbushen këto përcaktime promotive në dy gjysmëvjetorë të njëpasnjëshëm, pason rikthimi në nivelin e parë më të ulët të shkollimit ose një përsëritje. Nxënësit e shkollës reale duhet që në shumicën e lëndëve kryesore të kenë notën 4 ose më të mirë, që të kalojnë pa kusht në gjysmëvjetorin tjetër. Kalimi në shkollën sekondare sipas rregullit bëhet pas klasës së 6-të, ndërrimi pas vitit të parë real, pra pas klasës së 7-të, është po ashtu i mundur.

Mënyra e kalimit

Në fund të gjysmëvjetorit të parë të klasës së 6-të, në kuadër të mënyrës së kalimit, mësimdhënësit sqarojnë se



në cilin nivel të shkallës sekondare I do të mësojë një nxënës/e. Qëllimi i kësaj mënyre është që zhvillimi i aftësive të nxënësve t'i përshtatet nivelit në të cilin do të ndihmohen më së miri. Bazë për këtë vendim të kalimit, caktimi nga këndvështrimi i mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve. Për një vlerësim më të mirë të zhvillimit të mëtutjeshëm shërben gjithashtu raporti i vlerësimit të klasës së 5-të.

Ndihmë mbikëqyrjeje për prindërit

Duke pas parasysh të ardhmen e shkollimit, pyetjet pasuese mund t'u nxisin për mbikëqyrjeje ose vrojtimin e fëmijës tuaj.

- A mëson fëmija juaj me dëshirë?
- A mund të koncentrohet mirë ai ose ajo?
- A ka fëmija juaj një masë durimi?
- A kupton fëmija juaj menjëherë, çfarë ka të bëjë një detyrë?
- A mendon mirë fëmija juaj, nëse ka të bëjë me zgjidhjen e një detyre?
- A përpiket ai ose ajo për zgjidhjen e detyrave të vështira?
- A punon fëmija juaj i pavarur?
- A punon fëmija juaj me kujdes?
- A i bën fëmija juaj detyrat pa e detyruar?

Punët orientuese

Gjatë klasës së 6-të mësimdhënësit bëjnë të ashtuquajturën punë orientuese. Kjo bëhet pa paralajmërim në

mësimin e rregullt. Ata planifikojnë, udhëheqin dhe vlerësojnë bashkë me mësimdhënësit e regjionit. Kështu mund të bëhet vlerësimi objektiv krahasues i rezultateve në shumë klasë. Puna orientuese u shërben mësimdhënësve që vlerësimin ta bëjnë në shkallë të duhur. Në mënyrën e kalimit do të marrin pjesë të gjithë nxënësit.

Raporti i kalimit

Mësimdhënësi i klasës mbledh të dhënat edhe nga mësimdhënësit tjerë për raportin e kalimit. Njoftimet i merr për përgjegjësinë e lëndëve në gjerëmanisht, frëngjisht dhe matematikë si dhe në sjelljet në mësim dhe punë gjatë gjysmëvjetorit të kaluar. Në bazë të këtij vlerësimi të lëndëve dhe zhvillimit të përgjithshëm pason caktimi për vitin e 7-të shkollor.

Protokolli i kalimit

Protokolli i kalimit përbëhet nga tri qëndrime të ndryshme bashkërisht, që do të thotë nga:

- rekomandimi i mësimdhënësve;
- dëshira e nxënësit/es;
- dëshira e prindërve

Biseda e kalimit

Deri në fund të janarit të vitit të 6-të shkollor të fëmijës tuaj prindërit marrin një raport kalimi dhe protokoll kalimi. Pastaj fillon biseda e kalimit, e cila është kryesore. Aty marrin pjesë



prindërit, nxënësit dhe mësimdhënësit. Qëllimi bisedës së kalimit është formulimi i një propozimi për caktim në një drejtim. Pas bisedës mësimdhënësi plotëson protokollin kalues dhe ia bashkangjet kërkesës drejtuar drejtorisë së shkollës.

Nëse nuk vjen deri te marrëveshja e përbashkët, bëhet një bisedë me marrëveshje, në të cilën drejtorja e shkollës do të marrë pjesë. Këtu sikurse mësimdhënësit poashtu edhe prindërit mund të marrin ndonjë person me vete. Nëse përsëri nuk vjen deri te marrëveshja, atëherë kërkesa e mësimdhënëseve po ashtu edhe kërkesa e prindërve do ti parashtrohen drejtorisë së shkollës.

provues. Në fund të këtij gjysmëvjetori takohet drejtorja përgjegjëse e shkollës për vitin e shtatë me kërkesë të mbledhjes së mësimdhënëseve për të marrë vendimin definitiv të ndarjes.

Rregullat e veçanta

Në kantonin e Bernës parimisht kalimi në shkollën sekondare I është rregulluar në mënyrë unike. Për të huajt dhe fëmijët e ardhur së voni, të cilët për shkakë shëndetësore nuk kanë vijuar mësimin një kohë të gjatë janë të mundshme rregulla të veçanta.

Vendimi për kalim

Vendimin për kalim për vitin e gjashtë shkollor e sjell drejtorja përgjegjëse e shkollës në bazë të protokollit kalues. Në shkollat, ku ofrohet mësimi shkollor real, sekondar dhe ai special sekondar, pason caktimi në një nivel përkatës veç e veç në lëndët gjermanisht, frëngjisht dhe matematikë. Ai që do të caktohet së paku në dy nga këto tri lëndë të shkollës sekondare, gjegjësisht të nivelit shkollor sekondar special, llogaritet si nxënës i llojit të shkollës përkatëse.

Gjysmëvjetori provues

Gjysmëvjetori i parë i klasës së 7-të vlen për nxënësit e klasës sekondare speciale dhe sekondare si gjysmëvjetor

Information für Eltern

zur Beurteilung in der Volksschule
und zum Übertritt in die Sekundarstufe I

Albanisch 239708

für den deutschsprachigen Kantonsteil
Download: www.erz.be.ch/beurteilung04





—